



A. METEORINA

09.08.2017

11



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	09.08.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 204/4
PËR/ZA/TO:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.62/2017 të dt. 26.07.2017 për lëndën Berzat Namlegji Nr. 04-353-55393 për ndërtimin e shtëpisë individuale, në ngastrën kadastrale Nr.2183-0 Z.K. Prizren/

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



INSTITUT I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE
INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA
INSTITUT FOR THE PROTECTION OF MONUMENTS
Nr. 407 Prishtinë 08.08.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 62/2017
Datë: 26.07.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i kërkesës/projektit për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim dhe garazhë – kuzhinë verore në ngastrën kadastrale Nr.02183 – 0 Z. K. Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit dhe arsyetimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues i cili duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e zyrtarëve profesional nga Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Berzat Namlegjiu nga Prizreni ka parashtruar kërkesen për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim dhe garazhë-kuzhinë verore në ngastrën kadastrale me numër 02183-0. Etazhiteti i objektit për banim do të jetë B+P+2, ndërsa garazha-kuzhina verore B+P+0. Parcela ekzistuese për ndërtim është e zbrazët. Objekti që do të ndërtohet gjendet në zonën e VI^{te} sipas planit të konservimit ku etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9.5 m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet deri 60 % e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës ku do të ndërtohet objekti gjendet Shtëpia e Musa Shehzadës që është i listuar në Listën e MKRS –së.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, konstaton se bazuar në Planin për Konservimin dhe Zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit – Zona e gjashtë (6), pala ka respektuar parametrat përkatës për zonën, dhe si të tillë e aprovon projektin.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

